



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0007

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Panelsite Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Primo Studio Sh.P.K kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komuna e Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit 093 Hartimi i projekteve të palestrave sportive -salla e sportit Kryshec me numër të prokurimit 635-24-8870-4-2-3, me 21/03/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE Primo Studio Sh.P.K me nr. 2025/0007 , e datës 03/01/2025, kurse vendimi i AK Komuna e Pejës lidhur me aktivitetin e prokurimit Hartimi i projekteve të palestrave sportive -salla e sportit Kryshec me numër të prokurimit 635-24-8870-4-2-3, anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 27.08.2024, Komuna e Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Konkursin e Projektimit B06 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull 093 Hartimi i projekteve të palestrave sportive -salla e sportit Kryshec me numër të prokurimit 635-24-8870-4-2-3.

Ndërsa me datën 17.10.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratë konkurs i projektimit dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 20,700.00 €.

Me 22.12.2024, OE Primo Studio Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 24.12.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.01.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Primo Studio Sh.P.K nr. 0007/2025 për lidhur me aktivitetin e prokurimit 093 Hartimi i projekteve te palestrave sportive -salla e sportit Kryshec me numër të prokurimit 635-24-8870-4-2-3.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Primo Studio Sh.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankuesi pretendon se : “Mungesa e Hapësirës për Administratë Në Detyrën Projektuese, është kërkuar që objekti të përfshijë një hapësirë të përshtatshme për administratën. Ankuesi argumenton se në projekt-propozimin e OE-së fituese është përfshirë vetëm një zyrë, e cila nuk i përmbush kushtet për të funksionuar si hapësirë administrate, duke e bërë projektin jofunksional sipas kërkesave të dokumenteve të tenderit.”

Pretendimi i dytë (II) : "Mungesa e Garderobave dhe Nyjeve Sanitare të Përshtatshme Ankuesi vëren se në projekt-propozimin e OE fitues nuk janë parashikuar garderoba dhe nyje sanitare të përshtatshme për sportistët meshkuj dhe femra. Sipas kërkesave të tenderit, çdo garderobë duhet të përfshijë një numër të mjaftueshëm të nyjeve sanitare dhe dusheve, por projekti i OE-së fitues nuk i plotëson këto kërkesa."

Pretendimi i tretë (III) : "Mungesa e Hyrjeve të Ndara për Administratë, Shikues dhe Sportistë. Dokumentet e tenderit kërkojnë që ndërtesa të ketë hyrje të ndara për administratën, shikuesit dhe sportistët, për të shmangur konfliktet në fluksin e lëvizjes. Ankuesi pretendon se në projekt-propozimin e OE-së fitues mungojnë këto hyrje të ndara, duke e bërë projektin jofunksional."

Pretendimi i katërt (IV) : "Mospërputhja e Sipërfaqes së Objekti me Kërkesat e Tenderit." Sipas Detyrës Projektuese, sipërfaqja e përgjithshme e objektit duhet të jetë mes 1000-1100m². Ankuesi argumenton se OE fitues ka propozuar një projekt me një sipërfaqe totale bruto prej vetëm 800m², duke mos përmbushur kriteret minimale të përcaktuara."

Pretendimi i pestë (V) : "Mungesa e Prezantimit dhe Elaborimit të Konceptit dhe Idesë.Në dosjen e tenderit kërkohet që projekt-propozimi të përfshijë një prezantim dhe elaborim të qartë të

konceptit dhe idesë në format tekstual, tabelar dhe grafik. Ankuesi vëren se në projektin e OE fitues, ky elaborim mungon plotësisht, duke shkelur kërkesat e tenderit."

Pretendimi i gjashtë (VI) : "Mungesa e Planit për Mbrojtje nga Zjarri. Një nga kërkesat kryesore të tenderit është përfshirja e një plani të qartë për mbrojtjen nga zjarri. Ankuesi pretendon se projekti i OE-së fitues nuk e përmban këtë element kyç, duke e bërë atë të papranueshëm për vlerësim."

Pretendimi i shtatë (VII): "Mungesa e Zgjidhjes Ideore të Infrastrukturës Përkatëse. Dokumentet e tenderit kërkojnë që projekt-propozimi të përmbajë një zgjidhje të qartë ideore për infrastrukturën përkatëse. Ankuesi argumenton se projekti i OE-së fitues vetëm e përmend këtë aspekt në një përshkrim të shkurtër, pa ofruar një zgjidhje konkrete."

Pretendimi i tetë (VIII) : "Mungesa e Projektit në Format Elektronik. Sipas kërkesave të tenderit, projekt-propozimi duhet të dorëzohet si në kopje fizike ashtu edhe në format elektronik (PDF, PLN). Ankuesi thekson se OE fitues nuk ka dorëzuar projektin në format elektronik, duke mos përmbushur një nga kërkesat themelore të dosjes së tenderit."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE Primo Studio Sh.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 7, 80 të LPP-se si dhe Neni 55, Pika 55.26.; Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Kërkojme nga Paneli Shqyrtues të: APROVOHET Ankesa e Ofertuesit me Kodin 1201 në lidhje me aktivitetin e prokurimit 093 Hartimi i projekteve të palestrave sportive -salla e sportit Kryshec me numër të prokurimit 635-24-8870-4-2-3. Te obligohet AK "Komuna e Pejës" që të Ri-vlerësohen ofertat e dorëzuara nga Operatorët Ekonomik në mënyrë të drejtë sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, Ligjeve dhe Rregulloreve në fuqi të Prokurimit Publik.

Përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim: "Operatori Ekonomik ME CODIN 1610 PRIMO STUDIO SH.P.K . me datën 23.12.2024 , ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: 093 Hartimi i projekteve të palestrave sportive -salla e sportit Kryshec me Nr. të Prok: 635-24-6877-4-2-3 nr i 635-24-045-423 nxjerr: Autoriteti Kontraktues , me datën 24.12.2024 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë: A.K respektivisht Juria profesionale (komisioni vlersues) pas analizes se kërkeses se juaj për Rishqyrtim duke marr për bazë kërkesën tuaj në platformen elektronike të datës: 22.12.2024 ,e ka trajtuar me kujdes kërkesën tuaj, dhe ka ardhur në përfundim se njejtë është e pa bazuar., Ju njoftojmë se Juria Profesionale ka vepruar në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit (DT), duke realizuar rivlerësimin e projektit me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë. Procesi i Rivlerësimit: Juria Profesionale ka shqyrtuar dhe analizuar në mënyrë të hollësishme të gjitha aspektet e projektit dhe dokumentacionit të ofruar nga ofertuesit, duke siguruar që çdo hap të jetë: Në përputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara në dokumentet e tenderit; Transparent dhe i paanshëm, duke respektuar të drejtat e të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Publikimi i Pikëve: Pas përfundimit të procesit të rivlerësimit, janë publikuar pikët për secilin nga ofertuesit pjesëmarrës. Rezultatet janë të bazuara në vlerësimin profesional dhe në kriteret e përshkruara në DT, të cilat ishin të njohura dhe të pranueshme për të gjithë pjesëmarrësit. Nëse keni ndonjë pyetje ose kërkonit sqarime shtesë rreth procesit të rivlerësimit apo rezultateve të publikuara, ju inkurajojmë të na kontaktoni në adresat tona zyrtare."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 15/01/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe

pretendimeve sipas ankesës me nr. 0007/2025, ndërsa me datë 30/01/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/0007, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues. Ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje lidhur me rekomandimin e ekspertit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashitjet dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Primo Studio Sh.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0007 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i pare (I): "Eksperti Teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 1 të OE ankues për kodin 1234, Komisioni i Vlerësimit nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë projektin e propozuar. Në dokumentet e tenderit është kërkuar që në hapësirën për administratë të parashikohet një strukturë e përshtatshme për funksionet administrative. Megjithatë, në projektin e propozuar nga OE me kodin 1234, është paraparë vetëm një zyrë e vetme, e cila nuk i plotëson kushtet e kërkuara për administratë, duke e bërë projektin të papërshtatshëm sipas specifikimeve të tenderit. Për rrjedhojë, pretendimi nr. 1 i OE ankues konsiderohet plotësisht i bazuar.."

Konstatimi i dyte (II): "Eksperti Teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 2 të OE ankues për kodin 1234, Komisioni i Vlerësimit nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë projektin e propozuar. Në projektin e dorëzuar nga OE me kodin 1234, tek kërkesa për "Garderoba dhe nyjet sanitare për Femra (sportiste)" dhe "Garderoba dhe nyjet sanitare për Meshkuj (sportiste)", propozimi nuk është bërë në mënyrë të duhur, pasi: Një dush për dhomë është i pamjaftueshëm dhe nuk përmbush kërkesat minimale për funksionalitet dhe komoditet për sportistët. Mungesa e qasjes direkte të WC në garderobë nuk paraqet problem të madh, por duhet të jetë e qartë nëse kjo ndikon në funksionalitetin e përgjithshëm të objektit. Duke marrë parasysh këto konstatime, pretendimi nr. 2 i OE ankues konsiderohet pjesërisht i bazuar."

Konstatimi i trete (III) : "Eksperti Teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 3 të OE ankues për kodin 1234, Komisioni i Vlerësimit nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë projektin e propozuar. Në projektin e dorëzuar nga OE me kodin 1234, është parashikuar vetëm një hyrje, gjë që nuk është e rekomandueshme. Për rrjedhojë, pretendimi nr. 3 i OE ankues konsiderohet plotësisht i bazuar."

Konstatimi i katert (IV): "Eksperti Teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 4 të OE ankues për kodin 1234, Komisioni i Vlerësimit nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë projektin e propozuar. Në projektin e dorëzuar nga OE me kodin 1234, sipërfaqja totale bruto e objektit është vetëm 800 m², ndërkohë që sipas kërkesave të detyrës projektuese, sipërfaqja duhet të jetë nga 1000 deri në 1100 m². Për rrjedhojë, pretendimi nr. 4 i OE ankues konsiderohet plotësisht i bazuar."

Konstatimi i peste (V): "Eksperti Teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 5 të OE ankues për kodin 1234, Komisioni i Vlerësimit nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë projektin e propozuar. Në projektin e dorëzuar nga OE me kodin 1234, tek kërkesa për "Prezantimi dhe elaborimi i konceptit dhe idesë – format tekstual, tabelar, grafik", është paraqitur vetëm forma tekstuale, ndërkohë që format tabelare dhe grafike mungojnë plotësisht. Për rrjedhojë, pretendimi nr. 5 i OE ankues konsiderohet plotësisht i bazuar."

Konstatimi i gjashte (VI) : "Eksperti Teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 6 të OE ankues për kodin 1234, Komisioni i Vlerësimit nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë projektin e propozuar. Në projektin e dorëzuar nga OE me kodin 1234, tek kërkesa për "Mbrotja nga zjarri", informacioni është përshkruar vetëm pjesërisht, ndërkohë që nuk është paraqitur fare në formë grafike, siç kërkohet nga dokumentet e tenderit. Për rrjedhojë, pretendimi nr. 6 i OE ankues konsiderohet plotësisht i bazuar."

Konstatimi i shtate (VII) : "Eksperti Teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 7 të OE ankues për kodin 1234, Komisioni i Vlerësimit e ka vlerësuar drejt projektin e propozuar. Në projektin e dorëzuar nga OE me kodin 1234, tek kërkesa për "Zgjidhja ideore e infrastrukturës përkatëse", është prezantuar zgjidhja ideore nëpërmjet situacionit dhe përshkrimit. Duke qenë se kjo kërkesë është përmbushur sipas kërkesave të dokumenteve të tenderit, pretendimi nr. 7 i OE ankues konsiderohet i pabazuar."

Konstatimi i tete (VIII) : "Eksperti Teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 8 të OE ankues për kodin 1234, Komisioni i Vlerësimit nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë projektin e propozuar. Në projektin e dorëzuar nga OE me kodin 1234, tek kërkesa për "Projekti ideor dorëzohet në format elektronik (PDF, PLN) si dhe në kopje fizike", hartuesi i propozimit nuk i është përmbajtur plotësisht kërkesës, pasi: Projekti ideor është dorëzuar vetëm pjesërisht në formatin PDF. Në formatin PLN nuk është dorëzuar fare. Për rrjedhojë, pretendimi nr. 8 i OE ankues konsiderohet plotësisht i bazuar."

Perfundim nga eksperti shqytues: "Bazuar në analizën e detajuar të procesit të vlerësimit të ofertave, eksperti shqyrtues konstaton se ankesa e OE me Kodin 1201 është pjesërisht e bazuar. Vlerësimi i ofertave nuk është zhvilluar në përputhje me parimin e barazisë dhe trajtimit të drejtë, pasi vlerësimi maksimal i OE me Kodin 1234 nuk është mbështetur në një arsyetim të qartë dhe të bazuar në kriteret e dokumenteve të tenderit. Kjo nuk është në pajtim me nenin 7 të LPP-së, i cili garanton trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë. Po ashtu, neni 80, përcakton se juria duhet të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kriterëve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit. Pretendimi i ankuesit për shkeljen e kësaj dispozite është i bazuar, pasi nuk ka prova të mjaftueshme që vlerësimi është kryer ekskluzivisht mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, duke vënë në pikëpyetje procesin e vlerësimit. Gjithashtu, ankuesi pretendon shkelje të nenit 55, pika 55.26 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e cila kërkon që juria të sigurojë integritetin dhe paanësinë e procedurës së vlerësimit, duke u bazuar vetëm në kriteret dhe pikët e peshës të përcaktuara në Dosjen e Konkursit të Projektimit. Nga analiza e kryer, konstatohet se ky parim nuk është respektuar plotësisht, pasi ka mospërputhje të dukshme mes përmbushjes së kriterëve dhe vlerësimit të dhënë për OE me Kodin 1234. Për rrjedhojë, pretendimi i ankuesit në lidhje me këtë dispozitë konsiderohet i bazuar. Duke u bazuar në gjetjet e lartcekura, eksperti shqyrtues rekomandon që lënda të kthehet për rivlerësim, me qëllim garantimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe sigurimin e transparencës dhe integritetit në procedurat e prokurimit publik."

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues Primo Studio Sh.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues Primo Studio Sh.P.K. janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit 093 Hartimi i projekteve të palestrave sportive -salla e sportit Kryshec me numër të prokurimit 635-24-8870-4-2-3.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues/ Teknik i cili është i pranueshëm për Panelin Shqyrtues , ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik Primo Studio Sh.P.K.te aprovohet si e bazuar.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuara, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me titull 093 Hartimi i projekteve të palestrave sportive -salla e sportit Kryshec me numër të prokurimit 635-24-8870-4-2-3 të kthehet në rivlerësim, si dhe AK të veproj në harmoni me raportin e ekspertit shqyrtues/ Teknik duke respektuar dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - PRIMO STUDIO SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: